



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.178/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR dega në Fushë Kosovë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3.100 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me fotografi të printuara. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 09.06.2017, në rrugën Nëna Terezë në Fushë Kosovë, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR, të vendosura në hapësirë përkatësisht në pritore të autobusit.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e koalicionit LDK-AKR është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni LDK-AKR, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posteret e kandidatëve në hapësirë publike, përkatësisht në pritore të autobusit. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë, koalicioni LDK-AKR i datës 10.06.2017, kanë theksuar se pas pranimit të ankesës i kemi urdhëruar kandidatin që të ndërmarrë veprime përmirësuese, pra nga këto veprime edhe është evituar shkelja sipas pretendimeve në ankesë. Koalicioni LDK-AKR, pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku janë larguar posteret e kandidatës, Rafiqe Ternava - Beka, lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatës për deputete nga radhët e koalicionit LDK-AKR dega në Fushë Kosovë, janë vendosur në hapësirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterët e kandidatës për deputete nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 10.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.


Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti se posteret e kandidatëve nga ky koalicion janë vendosur në shtyllë publike pra në vende apo hapësira publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.178/2017 më datën 10.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.